

Ta bëjmë Steblevën më të bukur, më të gjelbëruar dhe më të begatë

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.22. Gusht 2011.

Çmimi 50 lekë.

EDITORIAL

Ja përse fitoi projekti i zhvillimit turistik të Steblevës

Nga Mersin Hoxha
Kryetar i Shoqatës "Stebleva"



Zgjedhjet e 8 majit 2011 për pushtetin vendor ishin një tregues sinjifikativ për mençurinë e popullit dhe të komunitetit të Steblevës. Komuniteti vlerësoi njeriun e duhur dhe alternativën e duhur, atë të zhvillimit turistik. Stacioni 20 vjeçar i kishte venitur shpresat dhe nuk pruri asgjë të re. Pushtetarë lokalë që nuk i njeh askush, bile as zona e tyre, vetëm vejetuan në këto vite. Triumfoi alternativa e zhvillimit. Triumfuan idetë e reja. Dashuria për vendlindjen triumfoi mbi gjithçka. Fitoi mendimi i lirë dhe përparimtar. Toka e të parëve ju bëri thirrje njerëzve. Shqiptarizmi triumfoi mbi dashakeqët dhe njerëzit e shitur. Partitë pro maqedonase dhe pro bullgare e panë se sa u vlente lëkura në komunën e Steblevës. Kandidati i mbështetur edhe nga Shoqata "Stebleva", biri i Steblevës Alban Fejza fitoi. Por me fitoren e tij fituan të gjithë demokratë e socialistë, myslimanë e ortodoksë.

Shoqata Stebleva i uron kryetarit të komunës Z. Alban Fejza për fitoren dhe ashtu si edhe gjatë fushatës edhe tani, gjatë gjithë kohës do ta mbështesë për realizimin e objektivave të tij dhe premtimeve elektorale.

(Vijon në faqen 2)

Fitoi projekti i zhvillimit turistik të Steblevës



FTESË PËR BASHKËPUNIM

Redaksia e gazetës "Stebleva" fton të gjithë bashkëpunëtorët e shtypit, intelektualët dhe qytetarët e thjeshtë të komunës së Steblevës të kontribuojnë me bashkëpunimet e tyre për të pasqyruar bukurinë e natyrës së Steblevës, historinë e saj të lavdishme dhe njerëzit e saj të mrekullueshëm.

NJOFTIM I SHOQATËS "STEBLEVA"

Shoqata "STEBLEVA" vlerëson kontributin e banorëve vendas që punojnë aktualisht në fshat për ruajtjen e vlerave të gjithanshme të tij dhe njëkohësisht u bën apel atyre që të bashkëpunojnë me banorët e shpërngulur, për të bashkërenduar punimin e të gjithave tokave të fshatit, por kjo të bëhet me marrveshjen dhe mirëkuptimin e të dyja palëve. Në të kundërt kjo përbën shkelje të të drejtave të njeriut mbi pronën dhe shkelësit e ligjit duhet të përgjigjen.

FALENDERIM

Falenderojmë zotin Artan Çausi, menaxher i përgjithshëm i firmës M&A Internacional, për sponsorizimin e numrit 22 të gazetës "Stebleva"

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI

ROLI I SHOQATËS "STEBLEVA" ËSHTË I PAZËVËN-

DËSUESHËM,
Nga Dilaver Abazi
FAQE 2

SHOQATA "AURORA", NJË SHOQATË E KRIJUAR PËR TË GRABITUR FONDE
FAQE 3

HISTORIA E FAMILJES DRAPA DHE KALVARI I VUAJTJEVE TË SAJ MIDIS DY SHTETEVE
FAQE 4

QAZIM GJINI, FIGURË E SHQAR E ARSIMIT SHQIPTAR
Nga Mehmet Hasani
FAQE 4

Origjina e familjes së Heroit të popullit Qemal Stafa është fshati Zabzun i Dibrës, sot komuna e Steblevës
FAQE 6

Poetja me shpirt të madh e sy të kaltër
Nga Prof. Murat Gecaj
FAQE 7

M&A
international
Artan ÇAUSHI
General Manager
Tiranë - ALBANIA
Adresa: Bulv. "Zogu i I" Parfumeri Fransild
E-mail: caushiartan@hotmail.com
Tel. +355 4 247 723
Cel. +355 69 20 21 946

XL SugarFree
XL Energy Drink

ANGELS TRAVEL&TOURS
Mersin Hoxha
Administrator
Bileta avioni, Trageti, Turizëm, Akomodim
Adresa: Rruga e Barrikadave, P. 218, Kati përdhe (Ngjitur me Lëvizjen "Mjafi", Afër Stacionit të Trenit)
Tirana - Albania
Tel/Fax. +355 4 2222519. Cel. 069 20 65 091
E-mail: mersin_hoxha@yahoo.com
angels.tours@hotmail.de

REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA". Drejtor: Mersin Hoxha/ Redaktorë: Halil Kurti, Asjap Gruda, Artan Lila, Reshat Gruda. Kryeredaktor: Sakip Cami

Ja përse fitoi projekti i zhvillimit turistik të Steblevës

(Vijon nga faqja 1)

Nuk ka rëndësi se cila forcë politike është dhe do të jetë në pushtetin qëndror gjatë periudhës katër vjeçare 2011-2015. E rëndësishme është bashkëpunimi në të mirë të komunitetit, realizimi i projekteve në dobi të tij.

Shoqata falenderon të gjithë ata që u kthen në vendlindje jo vetëm për të votuar siç pretendonin disa, por për të jetuar dhe punuar për zhvillimin ekonomik të zonës. Shoqata falenderon dhe respekton popullin e Sebishtit, Borovës, Zabzunit, Fushë Studnës dhe Llangës që mbështetën zotin Alban Fejza dhe na pritën e përcoollën si miq të vërtetë ashtu siç u ka patur dhe u ka hije.

Shoqata nga ana e saj zotohet para jush se nuk do të bëhet palë me ata që pengojnë zhvillimin, kushdo qofshin ata, por do të luftojë për realizimin e premtimeve dhe objektivave dhe ç'është më e rëndësishme do të luftojë për zhvillin infrastrukturor të zonës, zhvillim për të cilin ka aq shumë nevojë. Resurset nuk mungojnë dhe besimi ynë, mbështetja jonë do të jetë e vazhdueshme. Duke kërkuar bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj ne si shoqatë, duke i pasqyruar shqetësimet dhe problemet edhe në gazetën tuaj "Stebleva", ne do të jemi bashkë me ju në çdo moment dhe do të ngremë deri në instancat më të larta të pushtetit, zërin tuaj shqetësimit tuaja dhe do të luftojmë për zgjidhjen e tyre.

Ju nga ana juaj duke kërkuar llogari direkte si dhe nëpërmjet përfaqësimit do të jepnin ndihmesën tuaj për të mos rënë në apati dhe në plogështi. Tu themi ndal abuzimeve me fondet dhe me djersën e njerëzve tanë nga njerëzit e pushtetit.

Kryesia e Shoqatës ashtu si deri më tani do të jetë avokatja juaj në të gjitha drejtimet. Theksin kryesor do ta vemë tek kthimi dhe kompensimi i pronave, që të shkojë plotësisht prona tek i zoti dhe që njerëz të veshur me pushtet të mos na grabisin pronat tona, që zhvillimi turistik të zhvillohet mbi resurset tona dhe këto resurse të jenë baza e ekonomisë sonë.

Duke ju falenderuar edhe një herë tjetër për mbështetjen, ju premtojmë se fjalën e dhënë për ndryshimin e faqes së zonës sonë dhe për zhvillimin cilësor do ta mbajmë.

Punë të mbarë Kryetarit të ri të Komunës së Steblevës Alban Fejza dhe këshillit të ri të komunës të dalë nga zgjedhjet e 8 majit

Përbërja e këshillit të komunës

- | | | |
|-------------------------|-------------------------|--------------------------|
| 1. Fiqiri Kasem Gjini | 6. Agim Zeqir Teta | 11. Xhezmir Beqir Kaleci |
| 2. Gëzim Faik Alla | 7. Hajdar Adem Balla | 12. Murat Hamit Toçi |
| 3. Qazim Islam Laçkli | 8. Gëzim Halit Tupi | 13. Spahi Muhamet Rapi |
| 4. Rufije Kasem Gjini | 9. Pëllumb Qerim Gjini | |
| 5. Eduart Salih Çaushti | 10. Myslym Asllan Balla | |

Këshilli në mbledhjen e tij të parë zgjodhi kryetar Z. Fiqiri Kasem Gjini dhe nënkryetar Z. Gëzim Faik Alla. Sekretar këshilli u zgjodh Hekuran Hasa.
Punë të mbarë!

ROLI I SHOQATËS "STEBLEVA" ËSHTË I PAZËVËNDËSUESHËM, VLERËSIM DHE MIRËNJOHJE PËR SHOQATËN "STEBLEVA"



Nga Dilaver Abazi

Sa më shumë koha ka kalon, kuptohet roli i shoqatës "Stebleva" si një organizatë patriotike dhe kulturore-turistike e pa zëvendësueshme. Ajo lindi atëherë kur Stebleva kishte më shumë nevojë se asnjë herë tjetër. Njerëz të pushtetit dhe të pushtetshëm ishin sulur për të gllabëruar pyjet dhe pronat tona. Duhej një organizim për të përballuar këtë sulm të paparë ekonomik dhe çnjerëzor. Dhe këtë e bëri Shoqata "Stebleva". Ajo u krijua gjashtë vjet më parë dhe çdo ditë që kalon tregon se roli i saj është për ditë dhe më i madh. Djemtë dhe burrat e Steblevës me në krye ish kryetarin e Shoqatës Ali Fejza përballuan me forcë dhe u ndeshën me keqbrësit dhe dëmtuesit e pyjeve, me ata që donin të tjetëronin pronat tona. Këto burra lanë Tiranën, Durrësin, Elbasanin dhe familjet e tyre dhe qëndruan ballë për ballë me to derisa i larguan. Zotërinjtë Ali Fejza, Arianit Nura, Emrulla Hoxha, Hysni Disha, Abdyl Projku, Rexhep Kurti, Ferit Tamizi, Sami Disha, Shaziman Disha,

Sabriani Murati e të tjerë u përplasën drejt për drejt me abuzuesit dhe keqbrësit dhe mbrojtën pyjet dhe pronat e Steblevës. Kjo ishte përballja e parë sepse përballjet nuk do të mbarojnë. Më vonë kryetari i Shoqatës Mersin Hoxha do të ndeshet përsëri me plane të kamufluara e të hapëta për shfrytëzimin e pyllit të proit të govatave, të rrëmbimit të ujit nga Komuna e Ostrenit, etj. Kanë vazhduar gjyqet për këtë qëllim dhe janë fituar në fazën e parë. Do të vazhdojmë të luftojmë për mbrojtjen e resurseve topna në Steblevë sepse janë tonat dhe na i kanë lënë të parët tanë të cilët u vranë për këtë tokë.

Një rol të madh ka luajtur edhe gazeta "Stebleva", e cila i ka pasqyruar me guxim dhe me vërtetësi këto fenomene. Drejtori i gazetës Mersin Hoxha dhe kryeredaktori Sakip Cami kanë mobilizuar dhe aktivizuar njerëzit më të shquar të zonës sonë për të bërë sa më prezente shqetësimet dhe aftësitë tona. Njëzetë numrat e parë të kësaj gazete u përmbledhën në librin e parë "Stebleva" në saj të sponsorizimit të Z. Shyqyri Hoxha të cilin e fal-

enderojmë në emër të shoqatës.

Shoqata Stebleva aktivizoi edhe fondacionin gjerman GIZ për të ndihmuar fermerët dhe blegtorët steblevas. Ata erdhën dy herë në Steblevë të shoqëruar nga Kryetari i Shoqatës Mersin Hoxha dhe kanë hartuar një plan të detajuar për zhvillimin e turizmit familjar.

Z. Mersin Hoxha ka organizuar takim edhe me drejtorin për pikat doganore dhe kufitare në Ministrinë e Jashtme Mal Berisha për të bërë të mundur hapjen sa më shpejt që të jetë e mundur të pikës kufitare të Steblevës.

Së fundi Shoqata dha kontributin e saj për zgjedhjen e birit të Steblevës Z. Alban Fejza si kryetari i ri i Komunës së Steblevës. Këtë nuk e bëri për qëllime politike por për të bërë të mundur triumfin e alternativës më të mirë, alternativës së zhvillimit të turizmit, mbi atë të patates e të mbetjes në vend.

Ta mbështesim fort shoqatën "Stebleva" dhe kryesinë e saj sepse është një nga shoqatat që ka dhënë dhe po jep prova në interes të komunitetit të Steblevës.

REGJISTRIMI I PLOTË DHE KORREKT I POPULLSISË, NJË DETYRË E RËNDËSISHME E SHOQËRISË CIVILE SHQIPTARE

Kohët e fundit u miratua ligji mbi regjistrimin e popullsisë. Ne nuk jemi kundër regjistrimit të popullsisë, por kundër politizimit të qëllimshëm të tij. Çdo shtet e bën regjistrimin e popullsisë dhe kjo është një detyrë e rëndësishme e shtetit për shtetasit e vet. Zgjedhjet e 8 majit 2011 në një farë mase shkatërruan edhe pretendimet greko-serbo-bullgare për etnitetet e tyre dhe sasinë e tyre reale. Megjithatë ne si shoqatë dhe si shoqëri civile do të luftojmë fort për zbatimin faktik dhe real të këtij ligji dhe për shmangjen e çdo deformimi.

Cilat kanë qenë këto deformime në zonën tonë?

Në dy dekadat e fundit njerëz të ndryshëm të nxitur nga qëllime ekonomike dhe politike janë anëtarësuar në shoqata pro maqedonase dhe pro bullgare. Janë pajisur edhe me pasaporta maqedonase dhe bullgare gjoja në emër të lëvizjes së lirë. Atë që nuk e realizonte shteti ynë, ata e gjenin tek shteti bullgar. Ata dërguan fëmijët e tyre të shkollohen në universitetet e Shkupit dhe të Sofies me kontrata pro këtij shteti. Morën pasaporta të huaja me kusht që të lëshonin kombësinë shqiptare. Shumica e këtyre njerëzve morën dy pasaporta dhe dy kombësi. Shkolluan fëmijët e tyre dhe shëtitën nëpër Europë dhe nuk e tradhëtuan shtetin e tyre shqiptar. Kjo është e shpjegueshme. Këtë e kanë bërë edhe grekët e italianët që emigruan në Amerikë për arsye ekonomike. Por më pas u kthyen edhe më të fortë në atdheun e tyre.

Komuniteti ortodoks në zonën e Steblevës është i lirë të deklarohet për përkatësinë fetare, përkatësi që nuk i është mohuar asnjëherë. Si kudo në vendin edhe në Steblevë komuniteti ortodoks dhe ai mysliman jeton në harmoni me njëri tjetrin. Përsa i përket përkatësisë etnike duhet bërë kujdes. Dhe këtu duhet të bëjë kujdes komisioni shtetëror i regjistrimit dhe punonjësit e komunës. Këtu duhet të asistojë edhe puna e shoqatës Stebleva. Për shqiptarinë dhe Shqipërinë u vranë gjyshërit tanë dhe u zhvilluan tre lufta në Steblevë, më 1913, 1915 dhe 1920. Është paradoksale, sigurisht nëqoftëse do të ndodhë, që nipi sot deklarohet maqedonas mysliman, ndërsa gjyshi i tij 100 vjet më parë është vranë në luftë kundër serbëve, maqedonasve dhe bullgarëve. Jo vetëm që ka dhe do të ketë sanksione në bazë të ligjit, por kjo është e turpëshme që të shitesh për 30 aspra edhe sot, kur Shqipëria është anëtar i NATO-s dhe i lëvizjes së lirë në Europë.

Ne kemi besim që do të kryhet një regjistrim real dhe i lirë ku secili të shfaqë të dhënat e tij të mbrojtura nga ligji dhe nga Komventa për mbrojtjen e njeriut.

SHOQATA "AURORA", NJË SHOQATË E KRIJUAR PËR TË GRABITUR FONDE

Kohët e fundit është krijuar një shoqatë e re që vepron në zonën e Steblevës dhe të Fushë Studnit. Ajo drejtohet nga ish kryetari i këshillit të komunës së Steblevës Pëllumb Gjini dhe ka sekretar për mardhëniet me publikun Iridion Bahitin. Këto i mëson nga faqja e saj në internet. Por vetëm kaq sepse nuk ka asnjë lloj informacioni dhe transparence. Kur është formuar, Vendimi i Gjykatës, statuti, programi, misioni, kryesia, anëtarësia, gjithçka është e fshehtë.

Kush është prapa kësaj shoqate fantazme dhe pa identitet ?

Kush fshihet pas këtyre projekteve me financime jo transparente ?

Janë jo pak , por 6 projekte dhe miliona dollarë financime. Sa shkojnë këto projekte dhe financime në dobi të komunitetit të Steblevës dhe të Fushë Studnit ?

Projekti I : me donator REC për sistemimin e ujërave të zeza në dy lagje të komunës Steblevë (Fushë Studen). (Kanë ndërtu-

ar një gropë skeptike në Fushë Studen për turpin e tyre që nuk mund të shpjegohet.)

Projekti II : me donator VAF për menaxhimin e burimeve natyrore dhe qëndrueshmërinë e pyjeve në komunën Steblevë. Nga vetë titulli duket se nuk bëhet asgjë.

Projekti III : Me donator OSFA për rritjen e kapaciteteve për organizatat mjedisore dhe komunitetit Brenda Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë".

Projekti IV ; me donator OSFA për pjesëmarrjen e komunitetit

për eliminimin e efekteve të krizës ekonomike në zonën e Parkut Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë".

Projekti V : me donator IPA cross Border për mbrojtjen e mjedisit në arenën e parkut Kombëtar : "Shebenik-Jabllanicë".

Projekti VI : me donator AM-SHC për promovimin e turizmit malor nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit e burimeve natyrore për një zhvillim të qëndrueshëm të tij (Brenda Parkut Kombëtar "Shebenik -Jabllanicë".

Të gjithë e dimë se këto pyje

dhe këto pasuri i kanë mbrojtur banorët e Steblevës dhe të zonës për rreth, ndërsa tani na dalin disa njerëz të fshehur pas një shoqate që me siguri janë në Tiranë që kanë siguruar fonde për projekte pa fund, por që asgjë nuk kanë bërë për Steblevën. Ne kërkojmë transparencën e saj, aq më tepër që vepron në zonën tonë. Gazeta "Stebleva në numrat e ardhshëm si dhe mediat e tjera do të pasqyrojnë grabitjen e fondeve për zonën e Steblevës.

Bimët mjekësore, alternativa e ditës edhe për fermerët steblevas

Nga: DALI HORESHKA

VESTRIM HISTORIK

Qysh në vitin 2006, nepermjet SNV-se, me një grup pune të aktoreve lokal të Dibres u konkludua se ekonomite me fitimprurëse në bujqësi janë molla, arrat dhe bimët mjekësore. Për këto kërkime kërkohet si madhësi, qëndrueshmëri dhe standart por dhe nga rendesia ekonomike, bimët mjekësore renditen te parat.

PERSE KULTIVIMI

Një numer i madh i bimeve mjekësore me rendesi ekonomike dhe natyrore janë keqshfrytezur e mbi shfrytezuat. Bime të tilla janë Gentiana Lutea(shtara), dellina, sherbela, agulicja, meshtekna, shogogu, salepi, rrushi i ariut, lulebasani, çaji i malit, rigoni i kuq dhe molla e eger. **Ky regres ekologjik dhe ekonomik mund ti paksoje efektet dhe te nderpritet vetem ne se fillon dhe çohet me perpara kultivimi i bimeve mjekësore.** Aresy tjetër që e dikton kultivimin është ajo ekonomike. Struktura mesatare e kulturave të fermes anon kryesisht nga kultura me efektivitet të ulët, tregjo të garantuar dhe mundësi të pakta të sigurimit në kohe e me cilësi të inputeve. Jo vetëm kaq por një sasi prej 18000 ha në Diber dhe 150000 në shkallë vendi nuk janë "nen kulture" ose "jane jashte vëmendjes per tu shfrytezuat". Eksperienca ne profesionin tim, me llogaritë që bej, me thote se kjo siperfaqe e pashfrytezuat nuk është me e paket se mundësia per tu siguruar pune 18.000 punetoreve ne Diber apo 150.000 punetoreve ne shkallë vendi.

CILAT JANE BIMET ME TE KERKUARA NE TREG?

Ne konsultimet me specialist e tregtare te bimeve mjekësore rezulton se bimët me te kerkuara nga tregu jane sherbela, mentja, qumeshtorja, gentiana (shtara), shpatorja, agulicja, kamomili, terfili i kuq, delli i gjere, trendafil i eger, molla e eger dhe mellaga e bardhe (althaea officinalis).

CILET JANE DISA NGA TREGUESIT EKONOMIK TE BIMEVE MJEKËSORE TE KULTIVUARA?

Një ha i mbjelle me sherbele prodhon jo me pak se 60 kv ose afro 800.000 leke dhe kerkon një pune te gjalle jo me shume se 200 dite pune apo një punetor. Një familje e angazhuar e angazhuar me grum-

bullimin e sherbeles ne gjendje te eger, per tre muaj me tre veta ose 270 dite pune grumbullon 18-20 kv, ose 260.000 leke. Llogaria është e qarte: me 70% me pak fuqi punetore se me pare, merren tre fishi me shume se me pare. Ne total, bimët mjekësore te kultivuara kane me pak kerkesa per tokem, sherbimet dhe shpenzimet materiale (apo siç i quajne sot inputet).

Sa toke e destinuar per kultivimin e bimeve mjekësore, është afersisht e mjaftueshme per te siguruar te ardhurat vjetore qe mbajne një familje, e cila harxhon 400-500.000 leke ne vit?

Jane afersisht te mjaftueshme 5 dynym terfil i kuq, ose 7 dynym sherbele, ose 3 dynym shpatore ose 5 dynym qumeshtore, mente, bar blete, apo mellage e bardhe.

Investimi baze per faren ose fidanin mund te kushtojë: per 5 dynym terfil-10 kg fare ose 10.000 leke; per 7 dynym sherbele-1.5 kg fare ose 30.000 leke; per tre dynym shpatore-7 kv zhardhok ose 42.000 leke dhe per 5 dynym qumeshtore, mente, barblete ose mellage e bardhe-20.000 leke.

A EKZISTOJNE MODELET E KULTIVIMIT TE BIMEVE MJEKËSORE?

Per te qene real ne pohim, duhet thene se ekzistojne raste te kultivimit, por jo modele. Rajonet e Shkodres, Kukesit, Elbasanit ka vite qe vazhdojne te merren me kultivimin. Per aresye te rendesise qe ato kane ne permiresimin e te ardhurave te familjes , SNV Shqiperi nepermjet programit te saj Pro-Mali, ka nisur ndertimin e modelit te kultivimit te bimeve mjekësore me sherbelen. Ndertimi i ketij modeli konsiston ne:

a) Zgjedhjen e një sasive te kufizuar siperfaqeje dhe familjet ku do to mbillet sherbelja. Ne Diber ajo do te mbillet ne Çidhen dhe Reç me tre një një ha. Tokat do te zgjidhen kryesisht gelqerore dhe me eksspozicion nga juglindja.

b) Fidanat e çertifikuar, prej 4500-5000 cope per dynym do te jepen falas per fermeret e zgjedhur.

c) Fermeret do te keshillohet per menyren e kultivimit nga specialist te kontraktuar nga SNV, duke perfshire menyren e pergatitjes se fidanave, mbjelljen, sherbimet, vjeljen, tharjen dhe me teper. Gjate ketij procesi, fermeret do te pajisen dhe me broshura qe pershkruajne menyren e kultivimit te sherbeles.

d) Mbi kete baze, duke krijuar një pervoje rezultatesh te dokumentuar, do te zhvillohen takime lokale dhe kombetare, per ta shnderruar kultivimin e bimeve mjekësore ne strategji kombetare. Projekti do te synojë krijimin e një dialogu kombetar me Ministrine e Bujqesise dhe ate te Ambientit, per te krijuar bindjen se kultivimi i bimeve mjekësore është alternativa e permiresimit te fiores dhe te te ardhurave te familjes dhe per kete aresye duhen politika stimuluese, duke krijuar mekanizma, institucione e fonde perkatese.

PSE TE MOS PRODHUJME SHERBELE "BIO".

Per te prodhuar sherbele bio kerkohe te ndiqen standarte per një periudhe te caktuar e cila ndiqet dhe çertifikohet nga institucione te veçanta si "Albinpect", "Instituti i prodhimeve biologjike", "Shoqata e Bujqesise Organike". Diskutohet diferenca e çmimeve midis prodhimeve bio dhe jo bio. Kjo diference shpesh është me 1.5-2 fishin. **Cilesia e prodhimit ne vjelje, tharje dhe te qenit bio i certifikuar , nga fermeret te organizuar, është motori i vetem qe e ben fermerin lider edhe ne treg.**

Kjo është plotesisht e mundur per tu bere.

RRJETET LOKALE TE NIXITJES DHE SHKEMBIMIT TE IDEVE E PROBLEMEVE QE LIDHEN ME BIMET MJEKËSORE.(Klubet lokale te bimeve mjekësore)

Pa hyre ne detaje te analizet se organizimit dhe funksionimit te organizatave ekzistuese te fermerave, mbeshtet opinionin se ato deri tani kane patur me teper nxitje te jash-teme per tu krijuar dhe karakter kombetar ose rajonale sa i perket drejtimit dhe kurre nuk kane perfaqesuar realisht problematiken e fermes apo fshatit. Nevoja per te shkembyer praktika dhe eksperienca qe nuk jane te pakta, duke filluar nga ato ne nivel fshati, komune, rrethi apo rajoni, o behet shume e domosdoshme. Mekanizimi me te cilin ato mund te realizohen jane klubet/ rrjetet lokale te shkembimit te ideve. Nga ketu, pas formimit te një eksperience, mund te fillohet me nxitjen e krijimit te grupeve prodhuese.

AGJENCITE RAJONALE TE ZHVILLIMIT (ARZH-TE)

Eshte e kuptueshme se krijimi i rrjeteve lokale/klubeve te shkembimit te ideve, per te qene funksionale dhe te qen-

drueshme, kerkojne kosto dhe mbeshtetje. Kjo mbeshtetje mund te vije nga Agjencite Rajonale te Zhvillimit, nepermjet projekteve. Fatkeqesisht, ne rajonin e Dibres një agjenci i tille nuk është krijuar/nuk ekziston. Por, po kaq e vertet është se Qarku i Dibres, me mbeshtetje te SNV, ka ne funksion

ALCDF OSE FZHL (FONDACIONI I ZHVILLIMIT TE KAPACITETEVE LOKALE).

Fondacioni ben te mundur mbeshtetjen e zhvillimit te ideve edhe per kultivimin e bimeve mjekësore. Ne se një organizate lokale, qeverisje vendore , fermere apo biznes ka objektiva te tilla, nepermjet ketkij fondi, sipas procedurash dhe afatesh te percaktuara, duke paguar vetem 20% te koston, mund ti beje realitet ide te tilla. Nepermjet gazetes, dua me perzemersi te pershendes drejtuesit e komunave Zerqan dhe Xiber per aplikimet e tyre tek ky fondacion dhe te lidhura me Bimet Mjekësore. Vizioni i drejtuesve te komunave per zhvillimin duhet ndihmuar per te shkuar me lart. Fatmiresisht, menaxher i ketij fondacioni ne Diber është Zenulla Mehmeti, një specialist me mjaft pervoje dhe formim zhvillimi, i prirur per te bere te pamunduren ne funksion te zhvillimit.

PARTNERET E ZHVILLIMIT NUK JANE PAK

Ne se idete e zhvillimit behet te qarta dhe ekzistojne rrethanat per ta ngritur/zhvilluar kete ide ne ferme, biznes apo komunitet, mbeshtetja financiare është e mundur te sigurohet. Jane bere te njohura rastet kur idete "stisen" per te siguruar një mbeshtetje financiare ne vend qe idete te argumentojne zhvillimin.

Pikerisht pse ndodh edhe keshtu mjaft banka jane vene ne veshiresi dhe mjaft blloqe me kultura bujqesore dhe te financuara jane thare. Edhe pse ndodh edhe keshtu, ka mjaft fermere, biznese , organizata lokale e qeverisje vendore qe vleresojne idete e sigurta ne fillim dhe financen si mekanizem.\

Agjencia e Zhvillimit te Zonave Malore MADA, ka mbeshtetur projekte te zhvillimit te bimeve mjekësore. Ketej e tutje do te sugjeroja qe ta perfshije perseri rajonin e Dibres ne skeme, duke shpresuar se do te paraqiten aplikime per kultivimin, kerkimet, eksperimentet etj.

Une personalisht, kam opinionin se qeverisja vendore

mund te jete një partner shume i fuqishem i mbeshtetjes se zhvillimit. Me te drejte lexuesi mund te shtroje pyetjen SI dhe një po i pergjigjen duke sjelle një shembull. Praktika e filluar e kultivimit te terfilit te kuq tregon se 6 dynym te mbjelle me terfil te kuq kerkojne një investim fillestar prej 12 kg fare dhe qe kushton 12.000 leke, sa çështe dhe ndihma ekonomike minimale e një viti per një familje. Nga 6 dynym te mbjelle me terfil te kuq, nga viti i dyte deri ne te gjashtin, mund te merren 24-30 kv ne vit, te barabarta me 500-700 mije leke ne vit. Ky fermer qe u mbeshtet me 12000 leke dhe qe tani merr deri ne 700 mije leke ne vit, une nuk besoj se do ti drejtohet me zyrës se ndihmes ekonomike. Komuna, ne se vepron keshtu, merton keshtu prej fermerit një **SHUME FALEMINDERIT.**

QTTB-TE DHE DREJTORITE E BUJQESISE DUHET TE KTHEHEN NE FAKTOR KRYESOR I MBESHTETJES SE KULTIVIMIT TE BIMEVE MJEKËSORE.

Drejtorite Rajonale te Bujqesise kane treguar interesin dhe perkushtimin maksimal qe kultivimi i bimeve mjekësore te futet te "hullirin"e zhvillimit. Vendosja e një specialisti te veçante vetem per bimët mjekësore, mbeshtetja e QTTB-ve per te trajnuar keto specialiste, fillimisht vetem per kater rajonet e ProMalit (Diber, Korçë, Kukes e Shkoder), do te ishte një mbeshtetje e metejshme dhe garanci per te neserem.

Mentaliteti i fermerit per fermen ne favor te bimeve po ndryshon. Eshte koha qe edhe mekanizmat politik dhe ekonomik dhe shkencor te ndryshojne mentalitetin e tyre. Ata duhet mbeshtetur ne kete ndryshim. Une besoj se kjo mbeshtetje po u jepet nga programi i SNV-se Pro-Mali.

E gjitha sa është shkruar me siper, është diskutuar ne Diber me daten 6 korrik 2011 ne një takim me specialist, kultivues, grumbullues, pushtetin vendor, te cilet mbeshteten programin e SNV-se per kultivimin 2011-2012.

Pa marre persiper qe gjithçka e shkruar nga une pefaqeson me te miren, une do te ftoj specialiste qe njohin bimët mjekësore te shkruajne artikuj ne gazeta per njohjen e tyre, vendet ku ato rriten e zhvillohen, vlerat tregtare e kurative, menyren e tharjes dhe kultivimit, menyren e industrializimit, mbasi te tilla shkrime bejne te mundur ndryshimin e njerezve dhe i ndihmojne ato.

QAZIM GJINI, FIGURË E SHQUAR E ARSIMIT SHQIPTAR

Stebleva është një fshat me tradita të theksuara patriotike, kulturore e arsimore. Në gjerdanin e krenarisë dibrane Stebleva përbën një medalion me vete.

Në momente kyçe të historisë së popullit tonë steblesit kanë qenë qëndrestarë të fortë për mbrojtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, për kulturën dhe identitetin kombëtar.

Figura e Hazis Lilës padyshim është e spikatur fort në këtë qëndresë, pasuar nga patriotët të tjerë si Islam Lama, Hajdin Gruja e të shumë grave heroina.

Në fushën e kulturës figura poliedrike e Vaid Kormakut është unikale në trevën e Dibrës. Këto figura do të përjetësohen me kontributin e intelektualëve të tjerë të mëvonshëm si Islam Hoxha, Osman Uliu e në vazhden e tyre, padyshim vend të veçantë zë figura e intelektualit Qazim Gjini.

Si nxënës i Vait Kormakut figura e mësuesit do t'i bëhet pasionante për të dhe gjithë familjen. Pavaresisht se ai nuk punoi në Dibër, por si bir i Steblevës, i mbujtur me virtutet më të mira të kesaj treve, në tërë jetën e punën e tij në rrethin e Librazhdit e të Elbasanit rrezatoi mençuri dhe punoi me përkushtim për të përhapur dritën e diturisë në këto vende.

Ai lindi me 19 mars 1935 në fshatin Steblevë në një familje me tradita patriotike. Në vitet 1912-1922 si e gjithë Dibra, edhe Stebleva provoi mizoritë serbe duke u djegur tri herë. Njerëzit ikën muhax-

hirë. Ata u strehuan në Elbasan, Kavajë e Tiranë. Familja e Gjinajve qëndroi në Elbasan. Rregulluan një shtëpi e një dyqan, ku Qazimi që në vegjëli filloi të merrej me dyqanin e të ndihmonte familjen. Vitet e pasçlirimit, si në çdo sektor edhe në atë të arsimit kërkonin njerëz me përkushtim e sakrificë. Qazimi shpreh dëshirën që të punojë si arsimtar e në të njëjtën kohë të përfundonte arsimin e mesëm pedagogjik. Dëshira i plotësohet, por atje ku nevojat ishin më të mëdha, në zonat e largëta, ku ai do të ecte me orë të tëra në këmbë, ku suferina do ta burrëronte para kohe. Viti shkollor 1950-1951 do ta gjente në fshatin Kostenjë në zonën e Çermenikës.

Atje gjeti mikpritjen e Bajram Muçës, Hasan Kacës, Qamil Lukës si dhe do të kujtojë me respekt nxënësit e parë: Qemal Gjoni, Maksut Peshku, Ndrim Balla, Kamber e Shaqir Shehu, Farije Gjoni etj.

Ne vitet e para kujton me respekt mësuesit e zones: Refik Gjurani, Xhaferr Sinani, Skender Hoxha, Rrahman e Vesel Gjorgen, Avni Isarain, Zydi Shopin, Nafize e Naxhie Hoxha nga Elbasani, Naim Maliqi nga Tirana.

Ne qershor të vitit 1952, si perfaqësues i Seksionit të Arsimit asiston në provimet e lirisimit në Berzhesh. Ne ditarin e tij shkruan: "Berzhesh-tatë e Luftes, por dhe vendlindja e dy poetëve Genc Leka e Vilson Biloshmi, viktima të regjimit



totalitar. Gencin e njihja mire, sepse ai ishte arsimtar bashke me të shoqen e tij. Ishte djale i zgjuar, inteligjent e kritik, ndersa Vilsonin nuk e njihja, por kisha degjuar për poezite e tij" -faqe 22.

Ne vitin shkollor 1953 fillon punën bashke me të motren, ai në Kostenjë, ndersa Nefizja në Drenovicë. Për punë të mire transferohet në Orenjë, ku hapet shkolla 7-vjeçare me drejtor Zyhdi Shopin. Viti mesimor 1954-1955 e gjen në Letem se bashku me motren. Nga fundi i vitit transferohet në Qukes. Gjate kesaj kohe njihet e martohet me Remzie Oshafin dhe u lind djali i parë Ritfani.

Ne vitin shkollor 1959 fillon punën si drejtor shkollë në Gjyrak se bashku me të shoqen. Me 1961 emerohet drejtor shkollë në Hotolisht dhe me 1963 inspektor i arsimit për Prrenjasin. Në kete periudhë jep nismë për hapjen e shkolles 7-vjeçare të Nates në Sharre të Steblevës me mësues Zylfi Hasani (1959).

Ne vitin 1964 mbaron

fakultetin e Bio-Kimise dhe vazhdon punën si inspektor i arsimit. Me 1968 emerohet Shefi i Seksionit të Arsimit në Librazhd. Ne vitin 1970, për shkak të një perplasjeje me Ministrinë e Arsimit, në lidhje me terheqjen e të drejtave të studimit për në universitet, e shkarkojne dhe e emerojne drejtor i Shtepise se Kultures me regjizor Guliem Rado e shef muzike Sherif Mejdani.

Duke parë presionet dhe mosperputhjen e karakterit të tij me pushtetaret, kërkon transferim për në Elbasan. 20 vitet e punës si mësues dhe drejtues në Librazhd qene një shkollë e vertete jete plot me sakrificë, përkushtim, respekt për gjithë ato kolektiva mësuesish, nxënësish e kuadrosh. Kjo nostalgji do ta shoqeroje gjate gjithë jetes se tij. Me fillimin e vitit shkollor 1971 transferohet në Elbasan e fillon punë si mësues në Belsh me drejtor shkollë Eduard Osmani dhe zv.drejtoreshe Pranvera Grecen, kurse gruan e emerojne në shkollën 8 vjeçare Cerrik ku punoi për 17 vite me radhe.

Ne dhjetor të vitit 1972 emerohet drejtor i kinoklubit "metalurgjiku" detyre që e kreu për dhjetë vite me radhe e shoqeruar me vlersime dhe suksese nga drejtues e nga dhjetëra ndermarrje.

Ne dhjetor të vitit 1982 deri në vitin 1990, sa doli në pension, ka qene drejtor i shkolles se mesme të bashkuar, pa shkeputje nga puna në Cerrik. Ne të gjitha keto pune e levizje, ai ka qene dhe një prind i mire. Te kater femijet mbaruan universitetin e

sherbyen si mësues: Ritvani fakultetin e gjuheve të huaja dhe fillon punën si mësues në Gjocaj e Peqin, Arbeni-Shkollën e larte të mjeshterise sportive e fillon punën si mësues fiskulture në Gramsh. Dashamiri-mbaron shkollën e bashkuar, vajza e tij Zamira për mësuesi. Vitet e fundit, Ritvani, ka qene keshilltar në ambasadën tone në Kinë, kurse Zamira sot është inspektor e arsimi në Drejtorinë Arsimore Tirane.

Me të dale në pension shpërngulet familjarisht në Tiranë, ku jetoi e kujtoi me nostalgji vitet e punës me bashkefshatare të Steblevës, me shokë të punës në Librazhd dhe Elbasan, ku u gezua me martesat e femijeve, me nipat e mbesat, por edhe me hidherimin e madh të vdekjes se të shoqes, derisa edhe vete u nda nga kjo jete, nga familja, të afermit, miq e dashamires me 11.09.2009. Ai mban dekoratën "Medalja Naim Frasheri" e shume medalje pune.

Familja Gjini në Elbasan ka qene një familje e madhe me kontribute në sektorin e arsimit. Ne permendoren e arsimit, emrat e tyre janë të skalitur me respekt e dinjitet duke lene një trashëgimi të vyer dhe për brezat e rinj, një familje e madhe arsimtaresh të të gjitha profileve që i kane sherbyer dhe i sherbejne arsimimit të brezave, një faqe e ndritur në Obeliskun e arsimit në Shqipëri.

Mehmet Hasani
Zv/Kryetar i Unionit të
Krijuesve Dibranë

HISTORIA E FAMILJES DRAPA DHE KALVARI I VUAJTJEVE TË SAJ MIDIS DY SHTETEVE

Historia i pëplasi njerëzit nëpër dallgë ashtu siç deshi ajo dhe fati i njerzve përcaktohej edhe nga të tjerët. Kjo ndodhi veçanërisht në periudhën e regjimit komunist. Kështu i ndodhi edhe familjes Drapa, një familje e varfër e Steblevës, që përveç luftës për bukën e gojës ndihmonte edhe të tjerët.

Fillimisht familja Drapa ka jetuar në lagjen e Sollka mallës dhe më pas është larguar për në Llaikacë. Ka jetuar për pak kohë në Llaikacë dhe është rikthyer përsëri në Steblevë. Të gjitha këto lëvizje janë bërë për shkaqe ekonomike. Të gjitha këto i tregonte babagjyshi im Llambe. Llambeja u martua me të bijën e Isak Popes, një figurë e shquar në atë kohë. Miqësia me Isakun luajti rol të mirë për ta ndihmuar familjen Drapa. Vitet kaluan. Llambeja u bë me një djalë, Saven. Në fshat merreshin me bleg-

tori sepse tokën e kishin larg në Steblevë. Saven e rritën dajat. Kur u bë për ushtar ushtrinë e bëri në Serbi. Kur fillou Lufta e i Ballkanike dhe ajo Botërore, Save, largohet nga ushtria. Save martohet me një vajzë nga Jabllanica dhe pati me të katër fëmijë. Dy fëmijë lindën në Llaikacë dhe dy fëmijë lindën në Steblevë. Kthimi në Steblevë, ku kishin edhe tokën e tyre u bë rreth vitit 1942. U mendua se do të jetonin më mirë pasi kishin tokë të mjaftueshme. Fillimisht vendosen në shtëpinë e Stojan Gjinit sepse nuk kishin shtëpi. Më vonë ndërtoan një shtëpi, aty ku janë edhe sot. Tokën e punonin me argatë me hak sepse Save i kishte fëmijët e vegjël. Toka ishte e mitë dhe prodhonte misër e fasule. Bahgëtinë e kulloste vëllai i gjyshes Mitre Budini nga Jabllanica, një njeri i urtë dhe i varfër, por që dinte tu përshtatej kushteve të kohës.

Pas Luftës së II Botërore dhe mbylljes së kufijve Mitreja dhe Saveja nuk u takuan më kurrë.

Pas çlirimit të Shqipërisë Save mobilizohet në aksione të ndryshme. Gjatë kohës në fshat merrej me blegtori dhe me kullosjen e bagëtive në bjeshkë. Një ditë kur po kulloste bagëtinë dhe po mblidhte bar në Visharicë ndalohej nga patrulla e kufirit dhe shoqërohet për në postë dhe më pas për në Degën e Punëve të Brendshme në Peshkopi.

U akuzua për tentativë për kalim kufiri. Por kufitari që e kapi deponoi se e kishte gjetur duke mbledhur bar. Atëherë akuzohet për dezertim nga puna dhe largim për në bjeshkë pa adresë. Dënohet me tre vjet dhe bën gjysmën e dënimit. Pas kryerjes së dënimit vjen në fshat. Fëmijët tashmë ishin rritur dhe u bënë krah pune. Borisi

punonte në Ndërmarrjen e Mirmbajtjes së Rrugëve, Gojko punonte në pyjë, ndërsa Veloja punonte si usta në Fierzë. Rrusha u martua në Klenjë dhe pati katër fëmijë, tre djem dhe një vajzë. Me krijimin e kooperativave bujqësore familjes sonë ju muarën shumë bagëti Gjyshi nuk pranon dot as shkallmimin e kishave dhe të xhamive dhe mohimin e fesë në vitet 60. Regjimi komunist e kishte etiketuar familjen tonë si familje antikomuniste. Në fillim burgosin Borisin për agjitacion e propogandë. Bastisin shtëpinë dhe arrestojnë edhe gjyshin. Edhe muret e shtëpisë i bënë vrima vrima nga plumbat që qëllonin për të na terrorizuar. Të nesërmen një usta, mik shtëpie, bëri riparimin e mureve të shtëpisë. Trajtoheshim si familje e deklaruar me njerëz të burgosur dhe pa besim politik. Nuk mund ti afroshim kufirit as

për të kullotur bagëtinë. Në vitin 1983 Borisin lirohet nga burg dhe e sistemojnë në kooperativë bujqësore sepse nuk lejohej në punë tjetër. Unë mbarova shkollën e mesme me rezultate të larta fhe fillova të punoja në kooperativë sepse nuk lejohesh të vazhdoja studimet e larta. Krevat edhe shërbimin ushtarak. Para se të lirohesh nga ushtria vdes në burg gjyshi. Qava me dëshpërim, por pa më pa njeri. Një shkul urretjeje për regjimin më ishte mbledhur lëmsh. Ç'kishim bërë ne që trajtoheshim ashtu?

Por gjyshi thoshte se gjërat do të vonojnë, por do të shkojnë në vendin e vet. Dhe kështu ndodhi. Demokracia që kishim ëndëruar erdhi. Dhe e përqaftuam fort atë.

Ditë edhe më të mira do të vinë për këtë vend që e ka bekuar Zoti.

Cvetan Drapa

Osman Ismail Hoxha

Njeriu që mbarti mbi supe politikën sllave të pastrimit etnik dhe persekutimin komunist.

Për shkak të krizës ekonomike gjatë luftës së parë botërore, me dhjetra familje nga Stebleva, pa u shkëputur plotësisht nga fshati, ku ruajtën shtëpitë dhe pasurinë e tyre, emigruan në Shkup ku në saj të aftësisë dhe punës së palodhur në aktivitetet e ndërtimit dhe shërbimit social si guzhinjer dhe pastičier arritën të hapin dyqanet e tyre dhe të sistemohen me shtëpi në qendër të Shkupit. Midis këtyre familjeve ishte edhe familja e Ismail Hoxhës.

Osman Hoxha është lindur në vitin 1920 në qytetin e Shkupit, me prindër Ismail dhe Qerime Hoxha.

Në vitet 1931-1932, për shkak të politikës sllave të pastrimit etnik të Maqedonisë, me qindra familje të etnisë shqiptare u detyruan të largoheshin për në Shqipëri dhe në Turqi.

Si shumë familje të tjera nga Stebleva, familja e Ismail Hoxhës, pjesërisht shpërngulet në Stebleve dhe pjesërisht në Elbasan ku qëndroi për një kohë të shkurtër. Osmani ndonëse ishte në moshë të vogël, që në fëmijëri merr edukatën e punës. Pasi mbaron shkollën fillore në Stebleve, punon si çirak në punë të ndryshme në Elbasan, por aftësitë më të mëdha i shfaqti në zanatin e guzhinës dhe pastičerisë. Në vitin 1939, së bashku me vëllain e tij, Xhavitin hapin një ëmbëltore në Tiranë, tek sheshi Avni Rustemi, të cilën më vonë e ndryshuan në mëngjezore, me gatime tradicionale shqiptare, e cila me kalimin e kohës u bë mëngjezoria më me emër në Tiranë.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare dyqani i tij bëhet bazë e letërkëmbimit ndërmjet çetave partizane dhe Qarkorit të Tiranës. Sevo Tarifa, që punonte në ëmbëltoren e tij griste afishet e fashistëve. Në vitin 1943 martohet me Nedime Hoxhën (Shabani), bijë e Idriz dhe Hyrije Shabanit, familje e cila kishte ardhur edhe ajo nga Shkupi. Nga kjo martesë lindën dy fëmijë, Asija dhe Ismaili.

Mbas Luftës vazhdon punën në mëngjezore duke e kthyer atë në një nga mëngjezoret më të preferuara për qytetarët e Tiranës.

Osmani, megjithëse kishte jetuar shumë pak në fshatin e tij, Steblevë, kishte dashuri dhe respekt për steblevasit dhe gëzonte respektin dhe dashurinë e tyre. Steblevasit e kishin një mik në Tiranë dhe një shtëpi ku jo vetëm të flinin por edhe të kishin mbështetje për hallat dhe problemet e tyre. Miqësia me bashkëfshatarët e tij ishte aq e madhe sa nuk kishte gëzim familjar në Tiranë, Elbasan apo Steblevë ku të mos ishte i ftuar Osmani.

Osmani asnjëherë nuk e përbuzi emrin steblevas. Ai krenohet me origjinën e tij dhe këtë ua trashëgoi edhe fëmijëve të tij. Disa herë në vit shkante për të parë dhe vizituar fshatin e origjinës dhe bashkëfshatarët.

Megjithëse jetonte në kushte të mira ekonomike ai ndjente varfërinë e njerëzve të thjeshtë. Shprehte pakënaqësi ndaj regjimit dhe varfërisë. Kështu në vitin 1973 dënohet me 5 vjet burg për agjitacion dhe propagandë. Pas daljes nga burgu u sëmur nga zemra, duke kaluar tre infakte, që shkatërruan shëndetin e tij dhe shkaktuan vdekjen e tij më 12 tetor 1989.

Vdekja dhe varrimi i tij u shndërrua në një homazh në familjen e tij jo vetëm nga miqtë dhe shokët në Tiranë por edhe nga dhjetra steblevas të ardhur posaçërisht nga fshati për nderimin e fundit ndaj njeriut që i donte dhe e donin.

Pas 25 vjetësh, ballë për ballë me Daut Hodën

Në vitin 1945 Kadri Tamizi ishte kryetar i këshillit të fshatit. Së bashku me disa bashkëfshatarë të tij, me Qerim Shabanin, Sali Gjinin, Emrulla Fetën, Sadik Muratin, Mal Kormakun, Hasan Avdën, Vahid Tamizin, Sali Bajrën etj shkollon në Strugë për pazër siç shkonin zakonisht me kuajt shaluar. Kalojnë natën në një nga hanet e qytetit. Të nesërmen në mëngjez ulen në kafe.

-Nga ju kemi o burra, pyeti i zoti i kafesë.

-Nga Stebleva, përgjigjen steblevasit.

Në këtë kohë ngrihet Daut Hoda që kishte qenë në kafe dhe brofi në këmbë sapo dëgjoj fjalën Steblevë.

-Unë në Steblevë kam për të marrë hak, kam për të bërë gjak, kërcënon Dauti.

-Çfarë kërkove në Steblevë, or Daut Hoda në vitin 1920? Me vra vëllezërit e tu apo me çnderue gratë e fshatit, që ishin motrat e tua, në qoftëse je edhe ti shqiptar si ne? ju drejtua Kadri Tamizi. Në do me marr hak ja ku na ke ne. Dhe menjherë nxjerr nga poshtë pelerinës nagantin që kishte me leje si kryeplak katundi.

Daut Hoda ngriu sepse nuk e priste këtë përgjigje dhe këtë reagim me armë.

Ndërhyn menjherë edhe i zoti i lokalit dhe e nxjerr me forcë përjashta duke u thënë steblevasve: "Ju lumtë o trimat e Steblevës. Ja bëtë mirë atij faqeziu, që na e ka pas pru në majë të hundës edhe neve.

Dauti u zhduk nga sytë këmbët.

HASAN MALIQI (KORMAKU)

MJESHTRI I PUNËS ME DRU

(Njeriu ngë e bënte drurin të buzëqeshte)

Hasan Maliq Kormaku është lindur më 15 janar 1909 në një familje patriotike steblevase. Hasanit i ra mbi supe që në vegjëli barra e rëndë e mbajtjes së familjes sepse babai i tij, Maliqi vdiq në Stamboll ku edhe punonte. Bashkëshortja e Maliqit, nëna e Hasanit, Sulltania mbeti me tre fëmijë të vegjël në pikë të hallit.

Gjatë luftës së parë botërore ata shpërngulen drejt Elbasanit, në fshatin Bishqem. Në këtë fshat vdesin dy vëllezërit e Hasanit dhe nënë Sulltania me djalin e saj tashmë të vetëm kthehen në Steblevë dhe merren me blegtori. Në kohën e Zogut kanë patur edhe një dyqan të vogël shtëpi.

Që në moshë të vogël, Hasani mësoi zanatin e marangozit. Nga Stebleva Hasani shkoi në Durrës ku punoi tek Abil Kuçuku ku mësoi edhe zanatin e ndërtuesit, muratorit dhe zanatet e tjera të ndërtimit. Nga Durrësi shkon në Kuçovë ku punoi me një inxhinjer polak për ndërtimin e puseve të naftës.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka qenë korrier i Haxhi Lleshit dhe furnizues i partizanëve me ushqime dhe veshmbathje nga Struga.

Mbas çlirimit ka punuar në vepra të ndryshme industriale si në uzinën mekanike të Tiranës, në ndërtimin e kanalit "Naum Panxhi" Rrogozhinë, në ndërtimin e Hidrocentralit të Ulzës etj. U tërhoq nga veprat industriale me kërkesë të Rrethit të Dibrës si mjeshtër i punës me dru. Ai hapi në shtëpinë e tij një punishte për përpunimin e drurit ku përgatiste voza për bulmet, dyer, dri-

*Ka bashkëpunuar me mjeshterin
e punës Gani Tuçepi dhe së
bashku kanë ndërtuar vija uji,
kanale ujitëse, ujësjellësa, kanë
piketuar rrugë automobilistike
etj. Gjatë hapjes së sektorit të
sharrave të Steblevës ka
piketuar dhe ka ndihmuar për
hapjen e rrugës Posta e kufirit-
Mllaçe. Ka projektuar kanalin
ujitës për tokat e lagjes Kutle*

tare, parkete, tavane druri të punuara artistikisht, djepa fëmijësh, arka për pajat e nuseve etj.

Ka bashkëpunuar me mjeshterin e punës Gani Tuçepi dhe së bashku kanë ndërtuar vija uji, kanale ujitëse, ujësjellësa, kanë piketuar rrugë automobilistike etj. Gjatë hapjes së sektorit të sharrave të Steblevës ka piketuar dhe ka ndihmuar për hapjen e rrugës Posta e kufirit-Mllaçe. Ka projektuar kanalin ujitës për tokat e lagjes Kutle. Kishte një sy të jashtëzakonshëm piketues. Syri i tij nuk gabonte. Ishte aparat projektimi. Kishte një përvojë jetësore të habitëshme, por mbi të gjitha ai mbeti dhe njihet si mjeshtër i punës me dru, i latimit dhe

përpunimit të drurit. Tavanet e tij të ndërtuara që në vitin 1939 ruhen edhe sot dhe janë fjala e mjeshtërisë së dorës dhe syrit të njeriut. Revista "Shqipëria e Re" e vitit 1975 që botohej në shqip, anglisht, rusisht dhe gjuhë të tjera ka botuar fotot e punimeve artistike me dru të mjeshtër Hasan Maliqi.

Ai ishte edhe njeri i mrekullueshëm, një prind dhe shok i mirë. Ai rriti shtatë fëmijë, pesë vajza dhe dy djem duke u trashëguar atyre shpirtin patriotik dhe artistik. Me mustaqet që nuk i hoqi në asnjë kohë dhe me punën e tij të mrekullueshme artistike ai mbeti në kujtesën e të gjithëve një mjeshtër dhe një njeri i jashtëzakonshëm.

SHEFQET AGUSHI, MJESHTËR I PUNIMEVE ARTISTIKE

Shefqet Agushi, djali i dytë e Ramizit dhe i Alikes është lindur në Steblevë në vitin 1922. Që në moshë të re punon për të ndihmuar familjen. Në vitin 1944 inkadrohet në Brigadën e IV partizane për çlirimin e Shqipërisë.

Mbas çlirimit të vendit shkon në Elbasan dhe merret me ustallëk, murator dhe karpentier. Me hapjen e sharrave në Steblevë ka qenë ndër të parët e këtij stabilimenti së bashku me vëllezërit, Bajramin e Fehmiun. Por pas një kundërshtie apo proteste siç njihet sot, e përjashtojnë nga ndërmarrja pyjore.

Fillon ti përkushtohet zërtarisë. Si artizan i vërtetë dhe mjeshtër i punimit të meta-

leve të buta fillon dhe punon gjatë për përpunimin e floririt, argjendit dhe materialeve të tjera zbukuruuese. Përgatiste stolitë e grave dhe të vajzave qofshin këto prej ari, argjendi apo bakri, përgatiste zinxhirë qafe, bylyzykë, unaza, etj.

Riparonte mullinjtë e kafesë, përgatiste dhe mprehte shtiza, vargjet metalike të veshjeve popullore etj. Këto shërbime kapërcyen kufijtë e Steblevës dhe në fshatrat e tjerë për rreth.

Së bashku me mjeshterin e përpunimit të gurit dhe të drurit, Hasan Maliqin, si dhe me vëllezërit e tij punuan dhe bënë vijën e ujit për Soskamalla, vijë uji që shtë edhe sot. Më vonë punoi në mullirin e fshatit dhe përgatiste

gurë mulliri jo vetëm për Steblevën, por edhe për fshatrat e tjerë.

Ai ishte edhe përpunues i llamarinës dhe i aluminit. Përgatiste soba për ngrohje dhe për gatim, borija sobe, govata, tenxhere, kazana etj.

Njerëzve në nevojë dhe atyre që bënin shtëpi të re i ndihmonte edhe vullnetarisht pa pagesë një ditë apo edhe më shumë. Në saj të punës së tij pa hile, me cilësi dhe me çmim të lirë kishte fituar zemrat e bashkëfshatarëve dhe të fshatarëve për rreth.

Ai u nda shpejt nga jeta, në moshën 60 vjeç, më 20 nëntor 1982, i përcjellë me dashuri dhe dhimbje nga mijëra banorë të Steblevës dhe të fshatrave për rreth.

Origjina e familjes së Heroit të popullit Qemal Stafa është fshati Zabzun i Dibrës, sot komuna e Steblevës

Qemal Stafa, (Hero i popullit), (1920-1942)

Të parët e Qemalit janë me origjinë nga Zabzuni i Dibrës dhe u vendosën në Elbasan si rezultat i dyndjeve serbo-bullgare e djegieve të herëpashërme të kësaj zone nga sllavët.

Rreth 200 vjet me parë, Zabzuni ka qenë qendër e madhe banimi me rreth 650 shtëpi, rrugë të shtruara me gurë që ndriçoheshin me fenerë.

Major Hasan Stafa, babai i Qemalit, bashkëstudent ushtarak me Mustafa Qemal Ataturkun

Në Elbasan lindi babai i Qemalit, Hasan Stafa, i cili, pasi mbaroi shkollën në qytetin e lindjes, studioi në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Meqenese ishte një nxënës shumë i mirë, pas gjimnazit studioi në Akademinë Ushtarake 'Harbije' të Stambollit, nga ku doli me gradën toger në vitin 1902.

Hasani ka pasur shok të ngushtë na akademinë ushtarake Mustafa Qemal Ataturkun, që u bë themeluesi i Turqisë moderne.

Kur shqiptarët shpallën pavarësinë nga Turqia, pas shumë vitesh në ushtrinë otomane në qytete, si Seresi, Selaniku, Manastiri, etj., kapiten Hasan Stafa u kthye në atdhe për të qenë plotësisht në shërbim të shtetit të ri shqiptar. Meqenese ishte njëri nga ushtarakët që pati luftuar për pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria osmane, ai është cilësuar si një nga oficerët e Pa-

Dylgjerin, bijë e një familjeje të pasur të qytetit të Elbasanit, mbesë e oficerëve patriotë kapiten Kamber Sejдини dhe kolonel Kasem Sejдини, ky i fundit ish-komandant i përgjithshëm i Xhandarmërise Shqiptare.

Me Sabrien, Hasan Stafa pati pesë fëmijë: Veliun, Jaldyzin, Alaudinin, Qemalin dhe Dritën, pa harruar këtu edhe një vajzë të birësuar nga shtresat e varfra që quhej Shahe Stafa, e cila i ka rritur të gjithë fëmijët dhe ka qenë kujdestare shtëpie në këtë familje.

Në vitin 1923 major Hasan Stafën, për arsye pune e transferuan në Shkodër. Në fillim e caktuan në detyrën e komandantit të garnizonit dhe më vonë drejtor të Zyrës së Rekruitimit.

Në Shkodër Hasani la emër të mirë, pasi ai i lironte para kohe ushtarët nga familjet e varfëra. Sot e kësaj dite në Shkodër, në kujtim të Hasan Stafës, ka një vend që quhet shtëpia e majorit.

Major Hasan Stafa ka pasur një bibliotekë mjaft të pasur, e cila pjesërisht ka mbijetuar deri në ditët tona, duke qenë kështu një nga reliket më të çmuara të familjes Stafa.

Hasan Stafa lexonte dhe zotëronte mirë katër gjuhë të huaja, turqisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Ai ishte besimtar dhe në shtëpinë e Stafajve respektoheshin të gjitha ritet fetare të besimit

këtë?

Qemal Stafa lindi me 1920, në një familje patriote, në Elbasan. Mësimet e para i kreu në Kolegjin Saverian të Etërve Jezuitë në Shkodër dhe më pas në Gjimnazin e Shkodrës, gjer më 1936, kur me familjen vendoset në Tiranë. Po në këtë vit nis mësimet në Gjimnazin e Tiranës, ku më 1937 formon celulën e parë komuniste. Më 1938 mbaron gjimnazin dhe në dhjetor të po atij viti regjistrohet në Fakultetin e Drejtësisë në Firence, po s'i vazhdon studimet dhe kthehet në Shqipëri, e arrestohet.

Në Kolegjin e Jezuitëve në Shkodër ka pasur shoqëri me Qemal Borjen, një intelektual i shquar i vendit tonë.

Edhe pse Qemali jetonte në një familje ku nuk i mungonte asgjë, ai përsëri vuante shpirtërisht për të varfërit që në atë kohë në Shkodër, ashtu si edhe në të gjithë Shqipërinë ishin shumë.

Në formimin e botëkuptimit të tij si revolucionar kanë ndikuar veprat e Dostojevskit, të cilat ndodhen që nga ajo kohë në bibliotekën e shtëpisë. Po kështu edhe veprat e Tolstojt kanë ndikuar tek Qemali e ndër veprat e tij kishte në bibliotekë 'Ressurrezione', 'Sonata e Krojçerit' etj

Qemali zotëronte disa gjuhë të huaja si latinisht, frëngjisht, turqisht, italisht, greqishten e vjetër. Ai pati filluar të merrte njohuri edhe në gjuhën gjermane. Qemali ka lexuar dhe studiuar mirë edhe romanin e Gorkit 'Nëna', përkthyer në shqip nga Tahir Zavalani, libër ky i bibliotekës personale.

Kur profesori i gjimnazit të Shkodrës, Skënder Luarasi hapi një fushatë për zëvendësimin e festës allaturka me kapele, Qemali ishte një nga përkrahësit e tij kryesor. Mjedis i qytetit të Shkodrës e etikoi atë ateist dhe më vonë komunist. Të mos harrojmë se në atë kohë Qemali nuk ishte më tepër se 15 vjeç.

Bota shpirtërore e Qemalit pasqyrohet shumë bukur në shkrimet e tij, të cilat në kohën e Zogut i ka botuar në revistën 'Shtypi' dhe 'Bota e Re' e Korçës. Këto shkrime janë një fakt i pakundërshtueshëm që e vendosin Qemalin plot dinjitet në brezin e shkrimtarëve të rinj të viteve '30, brez që ka luftuar me pushkë e penë për përparimin e shoqërisë shqiptare.

Në një rast Qemali shkruan: 'Ndjeva turp kur pashë rrobat e mia të ngrohta pranë një njeriu të xhveshur, që po dridhej nga të ftohtit në një natë dimri. Dënova shoqërinë njerëzore, premtova'.

Në një bllok, aty nga viti 1935 kur ishte 12, 13 vjeçar, ku mbante ditarin e tij, Qemali shkruante: 'Sot, në nxënësit e klasës së 5-të A, vendosëm të bashkohemi dhe krijuam sho-



qërine 'Besa Shqiptare'. Në këtë shoqëri bëjnë pjesë myslimanë, ortodoksë, çifutë dhe katolikë'. Këtu duket qartë se ç'dëshira ka pasur ai që në rininë e vet për ta parë të bashkuar popullin tonë pa dallim feje dhe krahine.

Në vitin 1936 vjen me banim në Tiranë dhe Qemali regjistrohet në Lice. Në kryeqytet ai shoqërohet me Vasil Shanton, Themo Vasin, Xhezmi Dellin, Ali Demin.

Veprimtaria e tij ra në sy dhe, në vitin 1939, Qemalin e arreston qeveria e Zogut duke e akuzuar si komunist. Në vitin 1939 qeveria e Zogut zhvillon një gjyq në ngarkim të 65 komunistëve, ku nga më kryesorët ishte Qemal Stafa.

Familja i caktoi avokat mbrojtës Fuad Asllanin, i cili, një ditë pasi kishte filluar të bënte mbrojtjen e shkëlqyer të Qemalit erdhi tek ne dhe i mërzitur i tha gjyqës: 'Qemali më përzuri dhe më tha se do të mbrohet vetë'. Në një nga seancat e gjyqit avokati i tha trupit gjykues: 'Ky është i ri dhe sirenat e komunizmit e kanë tërhequr, ashtu siç tërheqën Uliksin'.

Në kohën që Qemali vuante dënimin në burgun e Mbreshtanit, në Berat, familja Stafa u godit nga vdekja e vëllait të Qemalit, Dr. Veli Stafës, i cili pasi ishte diplomuar për mjekësi në Bolonj të Italisë punoi për disa muaj si shef klinike në Spitalin Ushtarak në Tiranë. Më pas ai shkoi për kualifikim në Francë dhe prej andej erdhi në Tiranë me arkivolin mbështjellur me flamurin kombëtar, porosi e studentëve që studionin në atë kohë atje.

Për vitet studentore të Qemalit në Firence të Italisë ka treguar shoku i tij i ngushtë ing. Vasil Shqahu, që ka thënë: 'Në provimin që Qemali

dha në Firence profesori italian e vlerësoi atë me notën 'dieci e lode', gjë tepër e rrallë për Fakultetin e Drejtësisë në atë qytet.

Më 4 shkurt hapet gjyqi, ku Qemali nga i akuzuar kthehet në akuzues. Në prill të 39-ës arratiset nga burgu. Më 8 nëntor 1941 merr pjesë në mbledhjen për themelimin e PKSH-së si përfaqësues i Grupit Komunist të Shkodrës dhe zgjidhet anëtar i Komitetit Central Provizor të kësaj partie. Me 23 nëntor 1941 zgjidhet dhe sekretar politik i KQ të Rinisë Komuniste Shqiptare. Shquhet për një aktivitet të gjërë në krijimin e organizatave të rinisë në rrethe të ndryshme, si në Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Delvine, Fier. Me 5 maj 1942 rrethohet tradhtisht në një lagje të Tiranës dhe vritet. Pikërisht në rrugën "5 Maji", ku është edhe lapidari i tij.

Krahas aktivitetit revolucionar Qemali ka lënë edhe një material letrar të pasur, si në poezi dhe në prozën e shkurtër.

Ai nisi të debutojë në letërsi që në moshë të re. Provat e tij të para janë hartimet e bukura që shkroi në bankat e shkollës. Më pas, me një punë këmbëngulëse, Qemali realizoi dhe krijime të vërteta letrare, ndonjë prej të cilave e botoi te 'Vatra e Rinisë', 'Bota e Re', 'Shtypi', me pseudonimin Brutus ose me siglën B-us.

Nota kryesore e krijimeve të Qemalit është revolta, qëndresa, ndaj dhe heroi i shkrimeve të tij është njeriu që nuk mposhtet nga vështirësitë.

Qemali lëvroi kryesisht prozën e shkurtër dhe pikërisht skicën e portretin.

Trashëgimia letrare si dhe figura e tij prej progresisti të shquar ngjallin nderim dhe respekt të thellë.



Veli Stafa

varësisë. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës, duke pasur parasysh nacionalizmin dhe patriotizmin e kapiten Hasan Stafës, atij dhe dy oficerëve të tjerë shqiptarë iu dha gradat e larta si major të ushtrisë shqiptare.

Në këtë kohë Hasan Stafa u martua me Sabrie Veli

mysliman. Këtë e vërtetojnë dy libra të Kuranit, shume të vjetër, që gjenden ende në bibliotekën e familjes, të botuar rreth 250 vjet më parë.

Si ra Qemal Stafa në kontakt me idete komuniste?

Kush ndikoi tek ai për

Poetja me shpirt të madh e sy të kaltër

Nga: Prof. MURAT GECAJ

1.

Jorrallë, njihemi me një njeri fare rastësisht dhe pastaj bëhemi miq të mirë, me respekt të ndërsjelltë. Megjithëse jemi në moshë të ndryshme, kështu ka ndodhur edhe në njohjen time, me poeten Venka Capa, me origjinë nga Gllorborda e Dibrës dhe me banim në Tiranë. E kam thënë edhe më parë, por nuk e kam "zbuluar" unë këtë gjë, se Interneti po i lidhë njerëzit, si asnjë mjet tjetër komunikimi. Aty e ka zanafillën edhe njohja ime me këtë poete të talentuar. Ajo kishte publikuar një poezi (nuk më kujtohet mirë, se cila ishte ajo) në një faqe Interneti dhe poshtë saj bëra një shënim të shkurtër e dashamirës. Ajo ishte prekur nga fjalët e mia dhe më shkroi një mesazh, me nderim e respekt.

Kështu, pastaj, mesazh pas mesazhi, duke patur në mes dhe të njohurin e përbashkët, shkrikmtarin e publicistin Pilo Zyba, me banim në Athinë, por i kudogjendur, jemi takuar në përrurime librash, në Muzeun Historik Kombëtar të kryeqytetit dhe në mjedise të tjera. Kujtoj këtu edhe një takim të këndshëm tonin, në

shoqërinë e kolegeve Raimonda Moisiu e Kozeta Zavalani dhe poetit Bajazit Cahani. Nuk e kam të saktë, por besoj se me Mondën shiheshin për herë të parë, pasi ajo jeton në Nju Jork. Ndërsa "gjurmët" e mëtejshme të lidhjeve të tyre i kemi edhe nga një mesazh i ngrohtë, që ajo i ka kthyer Venkës. Në të, shkruhen këto fjalë domethënëse: "Edhe unë të përqafoj, shumë e dashur. Jam e lumtur dhe krenare, që të takova ty, Venka Capa, Poeten me shpirt të madh e sy të kaltër, si thellësia e detit dhe mjaft ekspresivë, që tregonin se brenda tyre ka jetë e dritë. Suksesese e urime! Të përqafoj fort: Monda".

Ndërsa po i rendis këto radhë, gjithashtu, unë e kam para syve Venkën, me atë pamjen e buzëqeshur e plotë dritë jete. Bashkë e me kolegë të tjerë, kemi bërë dhe fotografi, të cilat i kam kujtim të rrallë. Tashmë, në njohjen e miqësinë tone, kemi dhe një të afërme timen, që na lidhë. Ajo është vajza nikajmërturase, me emrin e bukur, Dukate Bushgjoka. Jetojnë së bashku në një zonë të Tiranës dhe problemet e tyre shëndetësore kanë bërë, që jetën ta përballojnë me guxim, optimizmin dhe mirësinë, që rreza-



Venka, me Muratin

tojnë ndaj të tjerëve.

2.

Ai, që i ka lexuar fjalët e mësipërme për Venka Capën, sigurisht, pret që të flasim e të shkruajmë diçka për të edhe si poete, me ndjesi të holla e frymëzim të bukur. Në dorë kam vëllimin e saj të ri me poezi, i cili mban titullin simbolik, "Unë prek me frymë", ku ajo më ka bërë shënimin e ngrohtë të zemrës, si bija për prindin: "Babushit! Me shumë respekt, Venka për Ju. Tiranë, 26.06.2011".

Libri në fjalë fillon me shënimet vlerësuese për Venkën e krijimet e saj, nga Fatime Kulli (redaktore), Krishtaq F. Shabani, Prend Buzhala (kritik letrar, nga Kosova) e Pilo Zyba. Ndërsa në kopertinën e fundit janë shënuar këto fjalë të Fatimes: "Ky libër tregon, në çdo kohë, se edhe njerëzit me aftësi të kufizuara, janë njerëz me të drejta të barabarta. Venka Capa, me vëllimin e dytë me poezi, "Unë prek me frymë", tenton të lërë një shenjë në poezinë shqiptare".

Nuk mund të lë pa përmendur këtu edhe faktin se, në tubimin e sivjetëm mbarëkombëtar të poetëve, në Vushtri të Kosovës, Venka Capa u nderua me "Çmim të veçantë", për krijimet e saj të arrira.

Në këtë libër të dytë të saj, janë përmbledhur 67 poezi të frymëzuara. Sigurisht, është e pamundur

të jepet përmbajtja e tyre dhe as të analizohen ato, në një shkrim të shkurtër. Por dëshiroj të theksoj se tematika e tyre është e larmishme, buron nga ndjenjat e çiltëra të kësaj poeteje, që jeta ia ka kufizuar disa gjëra, por jo shpirtin e pasur e të pastër. Natyrshëm, poezitë e saj nuk mund të shpëtonin nga një hijë pesimizmi, si "revoltë" ndaj padrejtësisë së fatit të saj. Megjithatë, në radhët e poezive të saj gjen forca shpirtërore, që të ngrihet mbi fatkeqësitë dhe jetën ta jetojë, ashtu si i është paraqitur.

Poetja kërkon mbështetje edhe të vargjet, te poezia e saj: "Poezisë i dhashë gjakun e frymëzimit, / vargut i dhashë timbrin e përflakur, / heshtjen e ofshëmës së dhimbjes, rimën" ("Hapësirave të shpresës"). Venka është e ndjeshme ndaj bukurive të natyrës dhe dëshiron që ato të bëjnë strehë në shpirtin e saj: "Vjeshta e artë më ka trokitë në sy, / nga kopshti në tavolinë, / vështror një kokërr shegë e ca mollë, / car rush të zi e lajthi, / sikur duan të thonë: / Jemi këtu, për ju..." ("Flaka e oxhakut"). Ndërsa në poezinë "Dritësim, në oborrin tim", ajo shkruan: "Pranëvera në oborrin tim ka shtri magjinë e ylberit, / rrezja e diellit më fton në ngjyrën e argjendë, / portokalli lulen ka çelë në mirënjohje, / zambakët e bardhë në dyluftim me krenarinë..."

Në fillim të këtij shkrimi fola për cilësi e virtyte të mira të poetes Venka. Por edhe ajo vetë shkruan, me sinqeritetin

e njeriut zemërgjerë: "Jam e dashur, / bëj shumë për shoqëri, / fali gjithçka për miqësi... / Di të fali shumë dashuri". Nëpër vargjet saj, ajo kudo kërkon gëzim e lumturi, të cilat i ka pak të kufizuara nga jeta: "Botës do t'i bija përqafoj, / në shpirt do të ndizja zjarr, / gjithçka do e lija peng, / lumturisë t'i gjeja vend!..." ("Për pak lumturi"). Pastaj shkuan për çaste të gëzuara të jetës, (te vjershat "Më nungon", "Vetëm një çast", "Shpirt margaritar" etj.): "Shikoja hënën në sy, / e krejt pakuptuar, i dashur, / mendja më shkonte tek ty..." dhe më tej: "Vetëm shpirtin e dua të lirë, / të endem bashkë me të, / e pranë teje të vij!"

Me shpirt të ndejshëm poeteja dhe me "zemër të pastër", e privuar vetë edhe nga disa gjëra në jetë, ajo këshillon me sinqeritet: "Mbaje afër gotën e dashurisë, / pi herë pas here në të, / kërko nektarin e lumturisë, / qesh e gëzohu pa zë!" Dhe, si për ta përmbledhur tërë botën e pasur shpirtërore të saj, Venka Capa shkruan vargjet e bukur e domethënës: "Ndiçon natyra e shpirtit të kadiftë, / brenda magjisë së syrit jeshil..."

...Tani, kur po i mbylli këto pak radhë, para më del përsëri pamja e buzëqeshur e kësaj poeteje të re, me ndjenja ta pastra e të forta për jetën, por edhe me dhimbjen e shkakuar nga aftësitë e kufizuara shëndetësore. Ajo ka virtyte të larta njerëzore, një botë të pastër e të pasur shpirtërore, me dashurinë e respektin për cilindo, që njeh e miqësohet me të.




STEBLEVA, NATYRË E VIRGJËR, TOKË E PËRGJAKUR, NJERËZ TË MREKULLUESHËM

(Një libër me vlera të mëdha njohëse dhe edukative për brezat)

Që në fillim të librit autori, kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha bën një thirrje për të gjithë bashkëqytetarët e tij steblevas kudo që ndodhen për të bërë gjithçka që është e mundur për fshatin e tyre, për këtë bukuri të rrallë natyrore, dhuratë të përhendisë. Në pjesën e parë të librit të titulluar "Natyre e virgjër, dhuratë përhendie, dalin në pah bukuritë e rralla të këtij vendi të bekuar që është as më shumë dhe as më pak një perlë e natyrës shqiptare që mund të krahasohet pa frikë me Lurën, Thethin, Valbonën, Llogaranë etj. Dhe pikërisht tani kur kanë kaluar të paktën 20 vjet nga fillimet demokratike dhe largimet demografike, kur fëmijët e steblevasve janë nga 2-20 vjeç është më shumë se e domosdoshme që këta fëmijë të njohin vendlindjen e tyre, prejardhjen e baballarve dhe të gjyshërve të tyre dhe ta përjetojnë krenarinë e të qenit nga Stebleva. Libri është i pajisur edhe me një fashikull prej 16 faqesh me fotografi me ngyra ku shpalosen bukuritë mahnitëse të Steblevës. Në Steblevë është edhe Liqeni i Draganit, një liqen natyral i rrallë për nga bukuria dhe vendosja e tij mes maleve. Shkëmbi i Draganit i përbërë nga dy kanione gëlqerorë është unikal për nga bukuria dhe veçantia. Liqeni i Draganit duket sikur buron nga shkëmbi. Dhe në të vërtetë nga shkëmbinjë buron. Bukuritë natyrore të këtyre viseve janë të rralla dhe të pashpjegueshme. Këtu, gjatë verës vijnë shumë pushues sezonale, ditorë me çadra dhe me ushqime me vehte. Ka edhe tenda për tregtarët për tu ardhur në ndihmë pushuesve. Ky turizëm malor është i ngjashëm me atë të Liqeneve të Lurës, një turizëm dhe një natyrë e virgjër, e paparë, mahnitëse, befasuese, çlodhëse, argëtuese. Ka gjithashtu edhe livadhe e lëndina të gjëra pambarim, kullota alpine me bimësi të larmishme, me lule të bukura e të veçanta.

Vende me bukuri të veçantë në Steblevë

- FUSHA E STEBLEVËS, E PËRSHKRUAR NGA UJËRA PA MBARIM
- MALI I RADUÇIT, ME NJË LARTËSI 2082 METËR
- MALI I DRAGANIT, (SHKËMBI I DRAGANIT)
- LIQENI I DRAGANIT, KANIONET E LIQENIT



- GËSHTENJAT E EGRA, LULET TEK FUSHA E 30-ës,
- ÇAJRET E THATA, LIVADHET E VISHARICËS,
- KALLKANI, ME MAJËN E TIJ 2134 METRA
- MALI I STRATORIT DHE BURIMET QË RRJEDHIN PREJ TIJ,
- PYJET E MLLAÇËS, PYJET E KUSARIT, PËRROI I GOVATAVE,

- ÇEZMA E ATATURKUT VAKËFI I STEBLEVËS, FUSHA DHE PYJET RRETH TIJ etj

Të gjitha këto vende krijojnë një ansambël të pakrahësueshëm bukurish.

Libri vlerëson ata që i mbrojtën këto pasuri natyrore nga barbarët e pyjeve dhe të kullotave, ata që nuk u larguan nga Stebleva, por që qëndruan me stoicizëm në vendlindje

ndonëse me sakrifica ekonomike, ata që u kthyen dhe që kthehen duke ndërtuar dhe rindërtuar në Steblevë. Një pasuri të rrallë të pallogaritëshme përbën tapia e vitit 1937 dhe lista me pronat dhe pronarët e tokave dhe pyjeve.

Në pjesën e dytë të librit të titulluar "Tokë e përgjakur" vendin kryesor e zënë luftërat e kësaj treve atdhetare dhe arsimdashëse si dhe figurat kryesore historike të saj. Lufta e Ste-

blevës e vitit 1920 kundër serbeve tashmë ka hyrë në historinë e Dibrës dhe të Shqipërisë. Rrallë kanë ndodhur në Shqipëri masakra barbare si ajo e Qafës së Përvallit.

Një vend të rëndësishëm në këtë libër zë figura e Mustafa Qemal Atatürkut dhe e e origjinës së tij të herëshme nga treva e Steblevës dhe e Sebishit.

Stebleva, si rrallë çdo fshat apo trevë tjetër ka figura historike që kanë lënë gjurmë në historinë tonë kombëtare. Kështu në libër do të gesh jetën dhe veprën e Hoxhë Haziz Lilës, delegat i Kongresit të Manastirit dhe i Kongresit të Dibrës, Hoxhë Hasan Moglicës, delegat i Lidhjes së Prizrenit, i Kongresit të Elbasanit dhe të Dibrës, do të gesh të dhëna të panjohura për jetën e heroit të Popullit Qemal Stafa dhe të vëllait të tij shkrimtarit Dr. Veli Stafa. Në libër do të njihesh me gratë trimëresha të këtij fshati dhe të kësaj zone që u masakruan nga serbet me bajoneta. Vahid Kormaku, pa dyshim përbën një figurë të fuqishme të arsimit dhe të ekologjisë shqiptare, duke vazhduar më tej me Islam Hoxhën, të këtij arsimtari që përveç punës së tij të palodhur në arsim mbledhi dhe sistemoi historikun e kësaj zone patriotike. Në libër do të njihesh me inxhinjerin Selman Mersa që ndërtoi rrugët e Milanos, por edhe të Shqipërisë, me Kadri Tamizin që i tha Ndal Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve se këtu është Shqipëri dhe flitet shqip, me Adem Bojaxhiun kryeplakun në 30 vite që mbrojt të drejtat e Steblevës dhe të steblevasve duke filluar që nga tapia e vitit 1937.

Më e udhës për cilindo që lexon këto shënime për këtë libër, gjëja më e mirë që do të bënte ishte ta kishte këtë libër në bibliotekën e tij, që ky libër me vlera të jashtëzakonshme njohëse dhe edukative për brezin e sotëm dhe për brezat që do të vijnë të ribotohet e të shpërndahet si një hajmali për çdo banor të kësaj zone me njerëz të mrekullueshëm.

Libri flet edhe për njerëzit e thjeshtë, por që lanë gjurmë me punën e tyre në dobi të fshatit dhe të komunitetit, flet edhe për figura të fuqishme ta arsimit, kulturës dhe të shkencës si regjizori i mirënjohur Esat Musliu, doktori Ferhat Rada etj

SAKIP CAMI



Adresa Rruga e Barikadave Pallati 133 , Tel 222519, 0692065091